

KËRKESË
Nr. 4175, datë 16.6.2021

**PËR PUBLIKIMIN E THIRRJES PËR PROJEKTPROPOZIME NË FUSHËN E
TURIZMIT**

Thirrje për projektpropozime në fushën e turizmit

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit shpall thirrjen për përfitimin e mbështetjes financiare të projekteve në fushën e turizmit nga data 21.6.2021 deri më datë 21.7.2021. Qëllimi kryesor i kësaj thirrjeje është të forcojë konkurrencën dhe qëndrueshmërinë e sektorit të turizmit në Shqipëri, nisur edhe nga situata në të cilën ndodhet industria e turizmit, për shkak të gjendjes së epidemisë të shkaktuar nga infeksioni COVID-19, nevojitet fokusim në promovimin e destinacioneve turistike e të vlerave të trashëgimisë kulturore dhe natyrore vendëse, si dhe duke diversifikuar me modele inovative produktet turistike, duke zhvilluar modele të reja të funksionimit të aktiviteteve detare dhe të menaxhimit të vijës bregdetare. Duke pasur parasysh këta objektiva kryesore, thirrja e këtij viti është e ndarë në dy tematika:

1. Promovimin e destinacioneve turistike e të vlerave të veçanta të produkteve dhe atraksioneve turistike.

Nën këtë tematikë Ministria e Turizmit dhe Mjedisit do të bashkëfinancojë projekte që do të synojnë:

- Zgjerimin e aktiviteteve dhe të ofertave turistike, duke synuar forcimin apo krijimin e produkteve të reja turistike, që shkojnë për zhvillimin e vendit dhe përfitimet e mundshme për popullsinë lokale të rajoneve të ndryshme.

- Përfshirjen gjithnjë e më shumë në sektorin e turizmit të komuniteteve lokale, studentëve në promovimin përmes produktit turistik, sipas karakteristikave të destinacioneve turistike.

- Promovimin e produkteve turistike shqiptare.

2. Krijimi/zhvillimi/përmirësimi/i produkteve turistike specifike, në përputhje me kërkesën gjithnjë në rritje për paketa inovative, që ofrojnë përvoja të pazakonta me surpriza dhe ide stimuluese, përveç shërbimeve bazë standarde.

Nën këtë tematikë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit do të bashkëfinancojë projekte, që do të synojnë:

- Zhvillimin e produktit turistik në mënyrë inovative drejt produkteve të interesit të veçantë. Në këtë përfshihet hartimi i modeleve studimore e zhvillimore të aktiviteteve detare, si pjesë e turizmit blu, si dhe ngritjen e modeleve të menaxhimit të hapësirës së stacioneve të plazhit.

- Zhvillimin e produktit turistik gjatë gjithë vitit, në lidhje me veprimtari të ndryshme turistike me tematikë gastronominë, zonat rurale, etnografinë, trashëgiminë kulturore, trashëgiminë natyrore etj.

3. Përgatitja e studimeve apo e modeleve të produkteve turistike

Nën këtë tematikë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit do të bashkëfinancojë projekte, që do të synojnë:

- Përgatitjen e studimeve apo të modeleve të produkteve turistike, të cilat kanë në fokus mënyrat/format apo masat që duhet të ndërmerren për rimëkëmbjen e turizmit, pas gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga infeksioni COVID-19.

ANEKS 1
FORMULARI I APLIKIMIT
PËR PËRFTITIMIN E MBËSHTETJES FINANCIARE LIDHUR ME PROJEKTET NË
FUSHËN E TURIZMIT

Pjesa I. Informacione të përgjithshme

Titulli i projektit: *[Type text]*

Aplikanti (emri i personit fizik/juridik që aplikon/partneri 1): *[Type text]*

Statusi ligjor i subjektit që aplikon: *[Type text]*

Numri i regjistrimit të subjektit që aplikon: *[Type text]*

Vendi i regjistrimit të subjektit që aplikon: *[Type text]*

Data e regjistrimit të subjektit që aplikon: *[Type text]*

Adresa: *[Type text]*

Faqja në internet: *[Type text]*

Personi i kontaktit: *[Type text]*

Pozicioni i personit të kontaktit: *[Type text]*

Tel.: *[Type text]*

Email: *[Type text]*

Kohëzgjatja e projektit: nga data *[Type text]* deri në datën *[Type text]*

Vendi ose vendet e realizimit të projektit: *[Type text]*

Fusha dhe tema e projektit: *[Type text]*

Buxheti total: *[Type text]*

Fondet e kërkuara: *[Type text]*

Pjesa II. Përshkrimi i projektit

1. Qëllimi i projektit: Përshkruani shkurtimisht projektin, problematikën që ai adreson, si dhe argumentimin se si projekti u përgjigjet nevojave të identifikuara (maksimumi 10 rreshta).

2. Objektivat e projektit (*maksimumi 5 rreshta për secilin objektiv*):

2.1 *[Type text]*

2.2 *[Type text]*

2.3 *[Type text]*

2.4 *[Type text]*

2.5 *[Type text]*

3. Lloji i aktiviteteve sipas fushës, si dhe një përshkrim më i detajuar i aktiviteteve që janë planifikuar në çdo fushë (*maksimumi 5 rreshta për secilin aktivitet*):

3.1 *[Type text]*

3.2 *[Type text]*

3.3 *[Type text]*

3.4 *[Type text]*

3.5 *[Type text]*

4. A janë aktivitetet e propozuara të përshtatshme, praktike dhe në përputhshmëri me objektivat dhe rezultatet e pritura? (*maksimumi 5 rreshta*):

[Type text]

5. A përmban projekti tregues objektivisht të verifikueshëm lidhur me rezultatet e aktiviteteve? (*Maksimumi 3 rreshta për secilin aktivitet.*)

Aktiviteti 1

Rezultatet e pritura dhe treguesit: *[Type text]*

Aktiviteti 2

Rezultatet e pritura dhe treguesit: *[Type text]*

Aktiviteti 3

Rezultatet e pritura dhe treguesit: *[Type text]*

Aktiviteti 4

Rezultatet e pritura dhe treguesit: [Type text]

Aktiviteti 5

Rezultatet e pritura dhe treguesit: [Type text]

6. Cili është grupi ose cilat janë grupet e synuara? (Lutemi të përshkruani shkurtimisht, në mënyrë sa më të përmblëdhur, se cili është grupi parësor i synimit të projektit dhe se si kanë për t'i shërbyer aktivitetet e projektit.)

Maksimumi 5 rreshta: [Type text]

7. Qëndrueshmëria e projektit – impakti afatgjatë i projektit nga pikëpamja e problematikës së adresuar, fushës së zhvillimit të projektit, si dhe personit fizik/juridik që e propozon.

Maksimumi 5 rreshta: [Type text]

8. Në konceptimin, hartimin dhe zbatimin e projektit, a është respektuar e drejta e autorit?

Maksimumi 5 rreshta: [Type text]

Pjesa III. Partnerët (nëse ka)

Bashkërendimi i punës midis partnerëve. (Përshkruani natyrën e partneritetit. Shpjegoni bashkërendimin e punës midis partnerëve, duke përshkruar procesin e vendimmarrjes, si dhe funksionin dhe përgjegjësitë e secilit partner në zbatimin e projektit.)

Maksimumi 5 rreshta: [Type text]

Partneri 1 (Aplikanti)

a) Misioni. Cili është misioni i subjektit tuaj?

Maksimumi 5 rreshta: [Type text]

b) Struktura. Përshkruani strukturën e subjektit, duke përfshirë detaje, si numrin e të punësuarve dhe strukturën e menaxhimit.

Maksimumi 5 rreshta: [Type text]

c) Financimi. Si financohet subjekti juaj dhe cili ishte buxheti i tij për vitin paraardhës?

Maksimumi 5 rreshta: [Type text]

Partneri 2

Emri i personit fizik/juridik: [Type text]

Personi i kontaktit: [Type text]

Email: [Type text]

Adresa: [Type text]

Faqja në internet: [Type text]

Pjesa IV. Buxheti

Lutemi të përshkruani shpenzimet e përfshira për implementimin e projektit. Çfarë burimesh të fondeve të tjera janë të siguruar dhe të mundshme?

Lloji i shpenzimit	≠ e njësisë	Çmimi	TOTAL	Vetë aplikanti	Donatorët e tjerë I	Donatorët e tjerë II	MTM
I. Shpenzimet direkte te projektit							
1.							
2.							
3.							
4.							
5.							
6.							
7.							
8.							
9.							
10.							
Totali i shpenzimeve direkte							
II. Shpenzimet							

administrative (deri në 15% nga totali i kërkuar)							
1.							
2.							
3.							
4.							
5.							
Totali i shpenzimeve administrative:							
TOTAL (edhe në %) ¹							

Vini re! Në aplikimin e paraqitur nga subjektet aplikuese duhet të parashikohen edhe shpenzimet për auditimin e projektit.

ANEKS 2

PROCEDURAT PËR PËRFITIMIN E MBËSHTETJES FINANCIARE, LIDHUR ME PROJEKTET NË FUSHËN E TURIZMIT

Ministria përgjegjëse për turizmin, nëpërmjet fondeve të parashikuara në buxhetin e shtetit, financon projekte studimi, promovimi dhe edukimi apo modele inovative të produkteve turistike, në funksion të turizmit, të paraqitura nga persona fizikë dhe juridikë, vendës ose të huaj, privatë apo publikë që kanë në objekt të veprimtarisë së tyre turizmin.

I. Thirrja për aplikim

Shpallet thirrja për përfitimin e mbështetjes financiare, në lidhje me projektet në fushën e turizmit, në faqen zyrtare të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, në media, si dhe në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare, sipas formatit bashkëlidhur.

II. Kriteret e pjesëmarrjes

Subjektet pjesëmarrëse duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

1. Të paraqesin dokumentacionin e nevojshëm lidhur me statusin e tyre juridik, provuar me ekstraktin e regjistrimit dhe ekstraktin historik, si subjekt, NUIS-in, si dhe dokumentet që vërtetojnë se:

a) nuk janë në proces falimentimi dhe se kapitalet e tij nuk janë në proces ekzekutimi nga përmbaruesit (vërtetim nga gjykata, zyra përmbarimore);

b) nuk janë subjekt i procedurave për deklarimin e falimentimit dhe nuk ka një urdhër likuidimi të detyruar ose administrimi nga Gjykata, ose nuk ka një marrëveshje me kreditorët, ose ndonjë procedurë tjetër të ngjashme (vërtetim nga gjykata);

c) nuk janë dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale, si person juridik, ortak apo aksionar i shoqërisë (vërtetim nga gjykata dhe vërtetim të gjendjes gjyqësore);

ç) kanë përmbushur detyrimet për pagimin e tatimeve, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës (vërtetim nga tatimet);

d) kanë përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës; (vërtetim nga tatimet).

2. Të paraqesin argumente në mbështetje të propozimeve, që justifikojnë financimin e projekteve të rëndësishme të paraqitura prej tyre.

¹ Ju lutemi të llogaritni shumën totale që mbulon çdo donator (duke përfshirë dhe MTM-n dhe vetë aplikantin, qoftë ky individ apo organizatë), edhe si % e buxhetit total për projektin.

3. Të demonstrojnë që janë në gjendje të financojnë 100% të të gjitha kostove të projektit të propozuar përpara përfundimit të tij, provuar me kopje të certifikuara të bilanceve të dy viteve të fundit, të paraqitura në autoritetet përkatëse dhe raportet e auditit financiar, të certifikuara nga një subjekt i licencuar auditimi dhe kopje të deklaratave të xhiros vjetore.

4. Në aplikimin e paraqitur nga subjektet aplikuese duhet të parashikohen edhe shpenzimet për auditimin e projektit.

Kur aplikuesi është i huaj ai duhet të vërtetojë që i plotëson të gjitha kriteret e renditura më sipër. Nëse dokumentet e sipërpërmendura nuk lëshohen në shtetin e origjinës, atëherë mjafton një deklaratë noteriale me shkrim nga ana e tij.

5. Aplikuesi duhet të paraqesë edhe dokumentet e mëposhtme:

a) nëse aplikon si person fizik, duhet të paraqitet një CV dhe një portofol i veprimtarisë së aplikuesit;

b) nëse aplikon si person juridik, duhet të paraqitet një CV e subjektit dhe një portofol i veprimtarisë së tij të deritanishme.

6. Në projektet që do të përzgjidhen, subjektet duhet të përfshijnë:

a) qëllimin e projektit;

b) vendin e ushtrimit të veprimtarisë;

c) veprimtarinë që do të kryhet;

ç) çmimet e referencës për të gjitha aktivitetet që mund të nënkontraktohen;

d) mënyrën e menaxhimit të projektit dhe sistemin e monitorimit e të vlerësimit të tij;

e) treguesit e verifikueshëm dhe rezultatet e pritshme të projektit.

III. Metoda e aplikimit

1. Formulari i aplikimit (të cilin mund ta gjeni më poshtë në formatin *Word* ose PDF), pasi të plotësohet, duhet të dërgohet në adresën e email-it: info@turizmi.gov.al, brenda orarit zyrtar:

E hënë – e enjte: 08:00–16:30

E premte: 08:00–14:00

Shkarko formularin docx. www.turizmi.gov.al

Shkarko formularin pdf. www.turizmi.gov.al

Përveç formularit të plotësuar, në këtë adresë nuk duhet të dërgoni asnjë material tjetër.

2. Formulari i aplikimit i plotësuar, së bashku me dokumentacionin mbështetës referuar pikës II, duhet të dorëzohet në tri kopje pranë Zyrës së Protokollit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, në adresën: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë, *Albania*.

Pas dorëzimit të dokumentacionit shoqërues të aplikimit nuk është e mundur të tërhiqet dokumentacioni nga arkiva e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

2.1 Sipër zarfit të shkruhet qartësisht:

Drejtuar: Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit; Aplikim për përfitimin e mbështetjes financiare në fushën e turizmit; emri i aplikantit; titulli i projektit

3. Thirrja për kërkesëpropozimet për mbështetjen financiare në fushën e turizmit në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit është e hapur brenda 30 ditëve nga data 21.6.2021 dhe mbyllet më datën 21.7.2021 në përfundim të orarit zyrtar ora 16:30. Çdo aplikim apo dokumentacion i paraqitur pas kësaj date dhe këtij orari nuk pranohet.

4. Subjekti aplikues në përlllogaritjen e kohëzgjatjes së projektit duhet të mbajë në konsideratë afatet që janë përcaktuar për procesin e vlerësimit të kërkesëpropozimeve deri në nënshkrimin e kontratës. Për këtë thirrje, projektet fituese nuk mund të fillojnë para datës 19.8.2021 dhe duhet të përfundojnë deri më 31.12.2021.

IV. Financimi

1. Fondi në dispozicion për këtë thirrje për projektpropozime është 35 000 000 lekë me TVSH.

2. Për realizimin e projekteve konkurruese turistike, skema e financimit do të mbulojë deri në 50% të kostove të pranuarra e të miratuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. Projektet për të

cilat kërkohet një financim që kalon 50% të fondit buxhetor vjetor të parashikuar në buxhetin e shtetit, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Financimi nga Buxheti i shtetit nuk mund të jepet më tepër se një herë në vit për të njëjtin subjekt konkurrues.

4. Shpenzimet e nevojshme për shpërblimin e ekspertëve të pavarur do të mbulohen nga fondi buxhetor i parashikuar për mbështetjen financiare të projekteve turistike.

5. Ky fond shkon për projekte që zhvillohen në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

V. Procesi i vlerësimit

1. Procesi i vlerësimit të kërkesëpropozimeve për mbështetjen financiare në fushën e turizmit zgjat 15 ditë pune.

2. Procesi i vlerësimit do të kryhet nga Komisioni i Përzgjedhjes së Projekteve në Turizëm, i ngritur me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 31.5.2018, “Për përcaktimin e anëtarëve të Komisionit të Përzgjedhjes së Projekteve”.

3. Çdo propozim kalon nëpër dy faza të vlerësimit:

a) vlerësimi i personit fizik/juridik;

b) vlerësimi i projektpropozimit (formulari i aplikimit të propozimit).

3. a) Në procesin e vlerësimit të personit fizik/juridik, që paraqet kërkesën, do të merren parasysh:

- i. profili dhe reputacioni i personit fizik/juridik dhe kapaciteti zbatues/menaxhues i tij;
- ii. veprimtaria e deritanishme dëshmon se personi fizik/juridik ka në objekt të veprimtarisë së tij/saj turizmin dhe fushat e lidhura me të;
- iii. misioni i personit fizik/juridik dhe objektivat e veprimtarisë së tij të deritanishme përputhen me politikat dhe strategjitë e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit;
- iv. personi fizik/juridik ka përvoja të suksesshme me partnerë e donatorë të tjerë;
- v. personi fizik/juridik ka treguar qëndrueshmëri dhe është rritur me kalimin e viteve;
- vi. personi fizik/juridik ka kontribuar në fushën ku operon me produkte të rëndësishme;
- vii. personi fizik/juridik ka kapacitetin në terma të burimeve njerëzore dhe ekspertizën teknike, për të zbatuar/menaxhuar projektin;

Kriteret e mësipërme nuk duhet të shkurajojnë persona fizikë/juridikë të rinj, të cilët mund të përmbushin kriteret e tjera;

3. b) Në procesin e vlerësimit të projekt-propozimit (formulari i aplikimit të propozimit) do të merren parasysh:

- i. projekti i propozuar ka në objekt të veprimtarisë së tij turizmin dhe fushat e lidhura me të;
- ii. objektivat e projektit të propozuar përputhen me politikat dhe strategjitë e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit;
- iii. problematika e identifikuar është aktuale dhe argumentimi i nevojës për projektin e propozuar është bindës;
- iv. objektivat e projektit të propozuar përputhen me problematikën e identifikuar;
- v. origjinaliteti i projektit dhe cilësia e aktiviteteve të planifikuara;
- vi. aktivitetet e planifikuara përputhen me objektivat e projektit dhe hapat e zbatimit të projektit janë të qartë dhe përfundojnë brenda datës 31.12.2021;
- vii. shpërndarja e resurseve dhe bashkërendimi i punës midis partnerëve është efikas;
- viii. treguesit e përzgjedhur për matjen e rezultateve të aktiviteteve të planifikuara janë të përshtatshëm;
- ix. përpilimi i kostove financiare: kostot janë reale (çmimet janë të bazuara në referenca që aplikanti mund t'i argumentojë) dhe të justifikueshme (raporti kosto/rezultat është i pranueshëm);
- x. niveli i bashkëpunimit me persona fizikë/juridikë të tjerë, si dhe bashkëfinancimi;

4. Komisioni klasifikon dhe përzgjedh projektet në fushën e turizmit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune, pas përfundimit të afatit 30-ditor (tridhjetëditor) të parashikuar për paraqitjen e dokumentacionit nga subjektet e interesuara që kanë paraqitur kërkesëpropozime për mbështetje financiare.

5. Ministri, brenda 5 (pesë) ditësh pas paraqitjes së propozimeve nga Komisioni, miraton projektet në fushën e turizmit, të cilat do të përfitojnë financim.

6. Nëse kërkesëpropozimi përzgjidhet nga Komisionin i Përzgjedhjes së Projekteve dhe miratohet nga ministri, procedohet me njoftimin e aplikuesit, brenda 2 (dy) ditëve, për nënshkrimin e kontratës.

7. Nënshkrimi i kontratës kryhet nga ministri ose një person tjetër i autorizuar prej tij.

8. Procesi i monitorimit kryhet nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit pas lidhjes së kontratës dhe fillimit të projektit.